



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 29.12.2014
Nr. 0204-1763

PËR: Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës
Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
SË PEJËS Nr. 463-78750/2014 të pranuar më datën 22.12.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 463-78750/2014 të miratuar me datën 12.12.2014 nga Kuvendi i Komunës së Pejës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Vendim për shpalljen e interesit publik për patundshmëritë, me qëllim të realizimit të projektit të rregullimit të rrugës rajonale Pejë – Rozhajë bazuar në PZHK për turizëm në këtë rajon.

Me respekt,

Ljubomir Maric
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL.
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum:29.12.2014
Br.0204-1763

ZA: Gazmend Muhaxheri, gradonačelnik Opštine Peć
Islam Husaj, predsedavajući Skupštine Opštine Peć

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE PEĆ,
Br.463-78750/2014 dostavljen dana: 22.12.2014

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene po članu 81.4 zakona za lokalnu samoupravu, kao i uredbe br.02/2011, o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva (prilog XII), nakon razmatranja odluke Br.463-78750/2014 usvojene dana 12.12.2014 od strane skupštine opštine Peć, POTVRĐUJE zakonitost akta i ceni da je isti u skladu sa zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni akat koji proizvodi puni pravni efekat je kao sledeće:

- Odluka za proglašavanje javnog interesa za nekretnine sa ciljem ostvarenja projekta za rekonstrukciju regionalnog puta Peć-Rožaje na osnovu ORP za turizam u ovom regionu.

S'poštovanjem,

Ljubomir Marić
Ministar administracije lokalne samouprave

Kopija: Besnik Osmani, generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljena MALS-a
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

Në bazë të Nenit 11 dhe nenit 17, paragrafi 1, pika b) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008), nenit 4 paragrafi 1, nën-pika 2.4.1 Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nenit 8.paragrafi 1.dhe nenit 14 paragrafi 1. Pika b) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 12. Dhjetor 2014,në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, muar këtë

VENDIM
MBI SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK

I.MIRATOHET propozimi i DÇPJ-ike dhe Kryetarit të Komunës, ashtu që shpallet Interesi publik për patundshmeritë: një pjesë të Ngastat kadastrale nr.597/1, në sipërfaqe prej 00.01,00 ha ZK. Radac, pronë e bashkëpronarëve: Avdullah Rr.Sadrijaj, Sahit Rr.Sadrijaj dhe Brahim F.Sadrijaj, të një pjese të Ngast.kad. nr.597/2 në sipërfaqe prej 00.00,50 ha, ZK.Radac, pronë e z.Idriz A.Sadrijaj dhe një pjese të Ngastren kadastrale nr.360 ZK. në sipërfaqe prej 00.00,25 ha, Radavc KK.Pejë, në pronësi të bashkëpronarëve: znj. Milica Vidioviq e lindur Martinoviq, z.Dragomir M. Martinoviq dhe Dragiq M.Mirkoviq. me qellim të realizimit të Projektit të rregullimit të rrugës rajonale Pejë – Rozhajë bazuar në PZHK për turizëm në këtë rajon.

II. Shpallja e interesit publik bëhet me qellim që patundshmeritë e përshkruara në pikën 1. të këtij vendimi të kalojë në pronësi të Komunës së Pejës , e me qellim të realizimit të Projektit për rregullimin e rrugës e cila lidhet me rrugën rajonale Pejë – Rozhajë, me shtegun e Ujëvarës së Drinit të Bardhë, sipas Planit Zhvillimor Komunal, të miratuar me dt.14.05.2007 për zhvillimin e turizmit si një nga pikat më atraktive të këtij rajoni.

III.Pronat e shpallura si interes publik në pikën 1. të këtij vendimi do të shërbejnë ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik siq ceket në pikën 2. të këtij vendimi.

IV.Në bazë të këtij vendimi, Autorizohet Kryetari i Komunës të iniciojë procedurat e metutjeshme për shpronësimin e pronës në fjalë për interes publik konform dispozitave ligjore në fuqi.

V.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujeset: Kryetari i Komunës permes, dhe Drejtorinë për Çështje Pronësoro Juridike dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK.Pejë.

VI.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL. si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 463 - 78750, datë: 12. Dhjetor 2014



KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS VLADYKOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsivo Lokalne Samouprave i Administrimit Ministry of Local Government Administration			
Eura	22.12.2014		
Datum	Date		
Organizator	Nr. i Lendës	Simboli	
-71-	204-763		